

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I  
Z Y R T A R

---

vëllimi 9    numër 1    janar 2007

Data e botimit 26.01.2007



## P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.01, datë 17.01.2007 "Për miratimin e "Kalendarit të mbledhjeve dhe programit të punës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007"" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.03, datë 17.01.2007 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të monedhave metalike dhe kartëmonedhave për qëllime numizmatike, nga Banka e Shqipërisë"" 8
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 17.01.2007 "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"" 17





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 01, datë 17.01.2007

PËR

MIRATIMIN E "KALENDARIT TË MBLEDHJEVE DHE PROGRAMIT TË  
PUNËS TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN  
2007"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika "c" të ligjit nr.8269, datë  
23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozimin e  
Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Kalendarin e Mbledhjeve dhe Programin e Punës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007", sipas anekseve 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat organizative të Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi dhe të Kalendarit të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

## ANEKSI 1

### KALENDARI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2007

NR	PROBLEMET QË DO TË SHQYRTOHEN NGA KËSHILLI MBIKËQYRËS	DATA E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJES	DATA E PUBLIKIMIT TË RENDIT DITËS
1	• Miratimi i kalendarit të mbledhjeve dhe programit të punës të Këshillit Mbiqëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007.	17 janar 2007	15 janar 2007
2	• Miratimi i Deklaratës së Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2006.	31 janar 2007	29 janar 2007
3	• Mbi aktivitetin kreditues dhe depozitues të sistemit bankar gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2006.	14 shkurt 2007	12 shkurt 2007
4	• Miratimi i deklaratës "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri" për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2006.	28 shkurt 2007	26 shkurt 2007
5	• Miratimi i Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006.	21 mars 2007	19 mars 2007
6	• Analiza mbi gjendjen financiare të sistemit bankar për tremujorin e katërt të vitit 2006.	4 prill 2007	2 prill 2007
7	• Analiza mbi gjendjen dhe strukturën e monedhës në qarkullim në fund të vitit 2006 dhe projektimi saj për fundin e vitit 2007.	18 prill 2007	16 prill 2007
8	• Miratimi i opinionit të Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2007".	2 maj 2007	30 prill 2007
9	• Miratimi i Raportit Vjetor të Mbiqëqyrjes për vitin 2006.	16 maj 2007	14 maj 2007
10	• Analiza mbi gjendjen financiare të sistemit bankar për tremujorin e parë të vitit 2007.	6 qershor 2007	4 qershor 2007
11	• Vlerësimi empirik për studimin, kuantifikimin dhe modelimin e kanaleve të mekanizmit të transmetimit monetar.	20 qershor 2007	18 qershor 2007
12	• Miratimi i deklaratës "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri" për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2007.	18 korrik 2007	16 korrik 2007
13	• Miratimi i Deklaratës së Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2007.	31 korrik 2007	29 korrik 2007

14	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i Programit Monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007.</li> </ul>	29 gusht 2007	27 gusht 2007
15	<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza mbi gjendjen financiare të sistemit bankar për tremujorin e dytë të vitit 2007.</li> </ul>	12 shtator 2007	10 shtator 2007
16	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbi rezultatet e vrojtimit për ndërtimin e indeksit të besimit konsumator dhe të indeksit të besimit të biznesit.</li> </ul>	26 shtator 2007	24 shtator 2007
17	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbi zbatimin e parimeve të Komitetit të Bazelit për mbikëqyrjen bankare.</li> </ul>	10 tetor 2007	8 tetor 2007
18	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i opinionit të Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007".</li> </ul>	31 tetor 2007	29 tetor 2007
19	<ul style="list-style-type: none"> <li>Analiza mbi gjendjen financiare të sistemit bankar për tremujorin e tretë të vitit 2007.</li> </ul>	14 nëntor 2007	12 nëntor 2007
20	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i Programit Monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008.</li> </ul>	27 nëntor 2007	25 nëntor 2007
21	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i Buxhetit dhe i Planit të Investimeve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008.</li> </ul>	12 dhjetor 2007	10 dhjetor 2007
22	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi i Dokumentit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008 .</li> </ul>	26 dhjetor 2007	24 dhjetor 2007



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 03, datë 17.01.2007

PËR

MIRATIMIN E UDHËZIMIT "Mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të monedhave metalike dhe kartëmonedhave për qëllime numizmatike, nga Banka e Shqipërisë".

Në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 33, pika 3; nenit 39, pikat 1 dhe 2 dhe nenit 43 shkronja "c", me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin "Mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të monedhave metalike dhe kartëmonedhave për qëllime numizmatike, nga Banka e Shqipërisë", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit, me zbatimin e këtij udhëzimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI



## UDHËZIM

# “MBI PROCEDURAT E SHTYPJES, TË RISHTYPJES DHE TË EMETIMIT TË MONEDHAVE METALIKE DHE KARTËMONEDHAVE PËR QËLLIME NUMIZMATIKE, NGA BANKA E SHQIPËRISË”

## KAPITULLI I TË PËRGJITHSHME

### NENI 1 OBJEKTI

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave që ndiqen nga Banka e Shqipërisë, gjatë procesit të shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të monedhës metalike dhe të kartëmonedhës për qëllime numizmatike.

### NENI 2 BAZA JURIDIKE

Ky udhëzim nxirret në përputhje dhe në zbatim të nenit 33, pika 3; nenit 39, pikat 1 dhe 2; nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”i ndryshuar.

### NENI 3 PËRKUFIZIME

Në zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Banka” – është Banka e Shqipërisë;
- b) “Këshilli Mbikëqyrës” – është Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë;
- c) “Monedha dhe/ose kartëmonedha”-janë monedhat dhe/ose kartëmonedhat për qëllime numizmatike.

### NENI 4 MONEDHAT DHE KARTËMONEDHAT PËR QËLLIME NUMIZMATIKE

1. Monedhat dhe kartëmonedhat për qëllime numizmatike kategorizohen në:
  - a) “monedha dhe kartëmonedha për qëllime numizmatike”, pa kurs ligjor;
  - b) “monedha dhe kartëmonedha për qëllime numizmatike”, me kurs ligjor.
2. Monedhat metalike dhe kartëmonedhat për qëllime numizmatike

sipas pikës 1 të këtij neni, shtypen si rregull në përkujtim të një ngjarjeje, personaliteti apo objekti të trashëgimisë historike, politike, sociale, fetare, shkencore, kulturore, sportive, kombëtare ose ndërkombëtare etj., që përbëjnë objekt koleksionimi.

#### NENI 5

#### MONEDHAT DHE/OSE KARTËMONEDHAT PËR QËLLIME NUMIZMATIKE ME KURS LIGJOR

Shtypja, rishtypja dhe emetimi i monedhës metalike dhe/ose kartëmonedhës për qëllime numizmatike me kurs ligjor nga Banka e Shqipërisë, kryhen sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin "Mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

#### NENI 6

#### FAZAT DHE PROCEDURAT

Procedura për shtypjen e monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave, nga Banka, përfshin fazat e mëposhtme:

- a) Faza e parë – Përzgjedhja, miratimi i tematikave dhe i elementeve të monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave.

Kjo fazë përfshin:

- i. përzgjedhjen e tematikave që do të pasqyrohen në monedha metalike dhe/ose kartëmonedha; dhe
- ii. miratimin e tematikave si dhe të elementeve të tjera.

- b) Faza e dytë – Zhvillimi i konkursit.

Kjo fazë përfshin:

- i. zhvillimin e konkursit; dhe
- ii. vlerësimin e vizatimeve.

- c) Faza e tretë – Miratimi i vizatimeve.

Kjo fazë përfshin miratimin e vizatimeve të monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave.

- d) Faza e katërt – Shtypja.

Kjo fazë përfshin procesin e shtypjes së monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave.

## KAPITULLI II FAZA E PARË

### PËRZGJEDHJA, MIRATIMI I TEMATIKËS DHE I ELEMENTEVE TË MONEDHAVE METALIKE DHE/OSE KARTËMONEDHAVE.

#### NENI 7 PROPOZIMI I TEMATIKËS

Përzgjedhja e tematikës që pasqyrohet në monedha metalike dhe/ose kartëmonedha, kryhet si më poshtë vijon:

- a) Departamenti i Emisionit, bazuar në Programin Vjetor të Këshillit Mbikëqyrës, përgatit kërkesën drejtuar subjekteve sipas përcaktimit të shkronjës "b" të këtij neni, me qëllim propozimin prej tyre të tematikës që do të pasqyrohet në monedhat metalike dhe /ose kartëmonedha.
- b) Në përputhje me kërkesat e Departamentit të Emisionit sipas shkronjës "a" të këtij neni, tematika mund të propozohet nga:
  - i. departamentet e Bankës;
  - ii. institucione të historisë e kulturës;
  - iii. Federata e Koleksionistëve të Shqipërisë;
  - iv. si dhe nga individë dhe persona juridikë.

#### NENI 8 PËRZGJEDHJA E TEMATIKËS

1. Përzgjedhja e tematikës të propozuar sipas nenit 7 të këtij udhëzimi dhe të paraqitur pranë Departamentit të Emisionit, kryhet nga një Grup i Posaçëm, i ngritur për këtë qëllim në Bankë.
2. Grupi i Posaçëm i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ngrihet me urdhër të administratorit përkatës bazuar në propozimin e Departamentit të Emisionit.
3. Grupi i Posaçëm përbëhet nga 7(shtatë) anëtarë, të paktën 4 (katër) prej të cilëve janë punonjës të Bankës.
4. Anëtarë të jashtëm të Grupit mund të jenë specialistë nga Akademia e Arteve, nga institucione të tjera të historisë e kulturës etj.. Në urdhrin për ngritjen e Grupit të Posaçëm, administratori përcakton, në përputhje me dispozitat nënligjore në fuqi edhe masën e shpërblimit të anëtarëve të jashtëm të tij.
5. Mbledhjet e Grupit të Posaçëm zhvillohen pranë Departamentit të Emisionit, në praninë e jo më pak se 5 (pesë) prej anëtarëve të tij.

NENI 9

MIRATIMI I TEMATIKËS DHE I ELEMENTEVE

1. Departamenti i Emisionit, jo më vonë se tremujori i dytë i çdo viti, paraqet për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, tematikën e përzgjedhur nga Grupi i Posaçëm, sipas nenit 8 të këtij udhëzimi.
2. Këshilli Mbikëqyrës përveç miratimit të tematikës/ave sipas pikës 1 të këtij neni, bazuar në propozimin e Departamentit të Emisionit, miraton dhe elementet e mëposhtme të monedhave dhe/ose kartëmonedhave :
  - a) vitin përkatës të shtypjes;
  - b) vlerën emërore;
  - c) përmasat;
  - d) përbërjen e materialit për monedhat;
  - e) pastërtinë e materialit për monedhat;
  - f) formën; si dhe
  - g) elementet e detyruara për t'u pasqyruar në vizatime.

KAPITULLI III

FAZA E DYTË DHE E TRETË

ZHVILLIMI I KONKURSIT DHE MIRATIMI I VIZATIMEVE

NENI 10

NJOFTIMI PËR SHTYP

1. Pas miratimit të tematikës dhe të elementeve të tjera, të përcaktuara në nenin 9 të këtij udhëzimi, bazuar në propozimin e Departamentit të Emisionit, Guvernatori miraton me urdhër të veçantë masën e shpërblimit për fituesin/t e konkursit të vizatimeve, bazuar në fondet përkatëse të buxhetit për këtë qëllim.

Në urdhër përcaktohet plotësimi i kushtit të transferimit të së drejtës së autorit (copyright) nga fituesi i konkursit të vizatimeve, tek Banka.

2. Departamenti i Emisionit, jo më vonë se 15 ditë mbas shpalljes së vendimit të miratimit të tematikës, përgatit njoftimin për shtyp për zhvillimin e konkursit, dhe ia paraqet Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit për publikim, në organet kryesore të shtypit.
3. Njoftimi për shtyp përmban objektin (qëllimin) e konkursit për vizatimet, masën e shpërblimit si dhe kushtin e transferimit të së drejtës së autorit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, vendin, datën dhe kohën e tërheqjes së të dhënave që lidhen me

tematikat, specifikimet teknike dhe mënyrën e vlerësimit, si dhe vendin, datën dhe afatin e fundit të paraqitjes së vizatimeve.

#### NENI 11

##### DORËZIMI I VIZATIMEVE DHE ZHVILLIMI I KONKURSIONIT

1. Vizatimet (bocetat), paraqiten në Bankë dhe regjistrohen në Zyrën e Arkiv - Protokollit të saj, në format jo më të vogël se A4 (210 x 297) në zarf të mbyllur, ku të jetë shënuar emri dhe adresa e plotë e konkurruesit.
2. Punonjësi i Zyrës së Arkiv - Protokollit, lëshon një vërtetim për marrjen në dorëzim të zarfit me vizatimet, mban një evidencë, ku shënohet emri i konkurrentit, numri i referimit të zarfit si dhe numri i vizatimeve.
3. Punonjësi i Zyrës së Arkiv - Protokollit numëron me të njëjtin numër (të ndryshëm nga ai i referimit) vizatimet e një zarfi dhe i vendos ato në një zarf tjetër, i cili mbyllet dhe mban numërtimin që kanë vizatimet dhe përgatit një evidencë me vizatimet e paraqitura.
4. Konkurimi zhvillohet vetëm në rastet kur paraqiten jo më pak se tre konkurrentë, i hapur dhe pa përjashtuar mundësinë e ftesës nga Banka të piktorëve të afirmuar.

#### NENI 12

##### VLERËSIMI I VIZATIMEVE

1. Vizatimet e numëruara dhe të mbyllura sipas nenit 11, pika 3 të këtij udhëzimi, i paraqiten Grupit të Posaçëm të ngritur sipas nenit 8 të këtij udhëzimi, nga punonjësi i Zyrës së Arkiv – Protokollit brenda afatit të caktuar për paraqitjen e vizatimeve, në momentin kur është konkluduar se janë plotësuar kriteret për zhvillimin e konkurimit.
2. Vizatimet vlerësohen në mënyrë individuale nga secili prej anëtarëve të Grupit të Posaçëm. Vlerësimi kryhet në bazë të pikëve të përcaktuara paraprakisht nga Grupi i Posaçëm dhe përfshin këta komponentë:
  - a) idetë krijuese;
  - b) idetë kompozicionale;
  - c) realizimin e vizatimeve për përmbajtjen dhe formën e tyre në funksion të tematikës.
3. Pas vlerësimit nga secili prej anëtarëve të Grupit të Posaçëm, ky i fundit përcakton renditjen përfundimtare të konkurruesve, në bazë të shumës së pikëve të marra nga çdo vlerësim individual i anëtarëve.

4. Në përfundim të konkurimit, Grupi i Posaçëm i paraqet Departamentit të Emisionit vizatimin/et të vlerësuar/a me numrin më të madh të pikëve, së bashku me relacionin shoqërues.

#### NENI 13

#### MIRATIMI I VIZATIMIT/EVE TË PËRZGJEDHUR/A

1. Departamenti i Emisionit i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyrës, vizatimin/et e përzgjedhura nga Grupi i Posaçëm, sipas nenit 12 të këtij udhëzimi.
2. Këshilli Mbikëqyrës me propozim të Departamentit të Emisionit, shqyrton dhe vendos për :
  - a) vizatimin/et e dy pamjeve të monedhës metalike edhe/ose kartëmonedhës, bazuar në përzgjedhjen e bërë nga konkurimi, si dhe sugjerimet për përmirësimet e mundshme të propozuara nga ky departament;
  - b) sasinë e monedhave dhe/ose të kartëmonedhave.

Sasia e shtypjes së monedhave dhe/ose kartëmonedhave përcaktohet e tillë, që të plotësojë kërkesat e koleksionistëve dhe të të interesuarve të tjerë, duke marrë në konsideratë edhe përvojën e shitjeve, për prerje të shtypura më parë nga Banka.

### KAPITULLI IV FAZA E KATËRT SHTYPJA

#### NENI 14

#### PROCEDURA E SHTYPJES DHE NDJEKJA E ZBATIMIT

1. Departamenti i Emisionit, i paraqet kërkesën përkatëse Departamentit të Administrimit për fillimin e procedurave për shtypjen e monedhës metalike dhe/ose kartëmonedhës, pas përfundimit të procedurës së parashikuar në nenin 13 të këtij udhëzimi.

Departamenti i Administrimit realizon procedurat e shtypjes së monedhës metalike dhe/ose kartëmonedhës, në përputhje me aktet rregullative në fuqi të Bankës, në fushën e prokurimeve.

2. Departamenti i Emisionit ndjek zbatimin tekniko-teknologjik të kontratës për shtypjen e monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave.

NENI 15  
LËVRIMI DHE SASIA

1. Departamenti i Administrimit në bashkëpunim me Departamentin e Emisionit, marrin masa dhe organizojnë procedurën e lëvrimit të monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave nga prodhuesit.
2. Në çdo rast të shtypjes së monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave, me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës miraton sasinë që do të veçohet si fond i paprekur dhe për dhurata.

NENI 16  
RUAJTJA E MATERIALEVE PAS SHTYPJES

1. Materialet e përdorura për shtypjen e monedhës dhe/ose kartëmonedhës, pas përfundimit të procesit të shtypjes sipas nenit 14 të këtij udhëzimi, ruhen në Arkën Stok dhe/ose në Muzeun e Numizmatikës të Bankës.
2. Objekt i ruajtjes sipas pikës 1 të këtij neni, janë materialet e mëposhtme:
  - a) të gjitha provat (modeli) e monedhave metalike dhe/ose kartëmonedhave;
  - b) skarcot e rezultuara gjatë procesit të prodhimit deri në sasinë 20 copë;
  - c) modelet plastike dhe stampat-mëmë të monedhave, klishetë, lastrat si dhe;
  - d) filmat e kartëmonedhave.

KAPITULLI V  
RISHTYPJA E MONEDHAVE METALIKE DHE/OSE  
KARTËMONEDHAVE

NENI 17  
RASTET E RISHTYPJES

1. Banka rishtyp monedha metalike dhe/ose kartëmonedha, në rastet kur ka përvjetor të një tematike të trajtuar më parë dhe/ose e cila ka patur dhe ka interes për koleksionistët.
2. Monedhat metalike dhe/ose kartëmonedhat e rishtypura ruajnë të njëjtën pamje me ato ekzistueset por në to ndryshon "viti" që kanë të shtypur në trupin e tyre.

## NENI 18

### MIRATIMI DHE PROCEDURAT E RISHTYPJES

1. Departamenti i Emisionit, jo më vonë se tremujori i tretë i vitit ushtrimor paraqet për miratim në Këshillin Mbikëqyrës tematikat për rishtypjen e monedhave dhe/ose kartëmonedhave.
2. Procedurat e përcaktuara në nenin 14 të këtij udhëzimi, zbatohen nga Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Administrimit edhe për rishtypjen e monedhave dhe/ose kartëmonedhave.

## KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

### NENI 19

#### PUBLIKIMI I MONEDHAVE DHE/OSE I KARTËMONEDHAVE

Departamenti i Emisionit pas përfundimit të shtypjes dhe/ose rishtypjes së monedhave metalike e kartëmonedhave, dhe përpara hedhjes së tyre në qarkullim i dërgon njoftimin përkatës Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, i cili kryen publikimin e tij, sipas rregullave në fuqi.

### NENI 20

#### HYRJA NË FUQI

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 04, datë 17.01.2007

PËR

NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "MBI PROCEDURAT E NDËRHRYJES  
SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE  
VALUTORE".

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 2; nenit 43, shkronja "b";  
nenit 60, pika 2 dhe nenit 61, shkronja "a" të ligjit nr. 8269, datë  
23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozimin e  
Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës  
së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Pika 3 e nenit 16 të rregullores "Mbi procedurat e ndërhyrjes  
së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve  
valutore" miratuar me vendimin numër 75, datë 11.10.2006 nga  
Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, ndryshohet si më poshtë  
vijon:

"Kursi i këmbimit për transaksionet tregtare të përcaktuara në pikën  
1 të këtij neni, përcaktohet si më poshtë:

- a) për transaksionet *spot* kursi luhetet në intervalin  $\pm 0.50$  për  
qind të kursit zyrtar të këmbimit të Bankës, në ditën e lidhjes së  
marrëveshjes;
  - b) për transaksionet *forward*, përcaktohet nga kursi *spot* dhe diferenca  
e normave të interesit për afatin e marrëveshjes, të monedhave të  
përfshira në transaksion, në përputhje me standardet ndërkombëtare  
të tregtimit."
2. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha  
strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij  
vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI



